

Shqipëria ka bërë realitet në Armeni ëndrrën e saj 85 vjeçare (që prej krijimit të FSHF) për të marrë pjesë në finalet e një kampionati evropian futbollit, duke fituar 3-0 një ndeshje që vlente sa një histori.

Në Jerevan, Shqipëria luajti ndeshjen më të rëndësishme të Kombëtares, atë që na dha një biletë për në ‘Francë 2016’.

Nga 7 Shtatori i 2014-tës deri më 11 Tetor të 2015 Shqipëria ka përjetuar 13 muaj të jashtëzakonshëm kuqez, të cilët u kurorëzuan me një fitore. Në Armeni, Kombëtarja luajti për ëndrrën më të madhe të futbollit shqiptar, të jetë pjesë e një Europiani, të jetë mes më të mirave të kontinentit.

Në 13 muaj tifozët shqiptarë në çdo cep të globit janë gëzuar, kanë ëndërruar, kanë bëtitur ‘gol’, dhe kanë qëndruar për pesë ndeshje të pathyer, kanë luftuar dhe dyerve të gjykatave europiane, e si asnjëherë tjetër siguruandhe një vend në play-off, pas katër ndeshjeve të para, por edhe kanë vuajtur në minutat e fundit duke provuar jo thjesht dëshpërimin, por vuajtjen që mund të shkaktojë “krisja” e një ëndrre të madhe.

Fitorja në Armeni ishte jo vetëm një arrite për futbollistët që sot luajnë në Kombëtaren kuq e zi, por edhe për të gjithë ato breza dhe gjenerata të tëra lojtarësh që iu afruan kësaj ëndrre, por nuk mundën ta realizonin dot, për shumë shkaqe e rrethana të ndryshme. Fitorja sot ishte edhe për Loro Boriçin e Panajot Panon, edhe për Sokol Kushtën e Sulejman Demollarin. Ishte edhe për Igli Taren dhe Erjon Bogdanin, për Altin Lalën, Ervin Skelën, Alban Bushin e shumë të tjerë që kanë dhënë gjithçka për fanellën kuq e zi ndër vite. Prandaj rëndësia e kësaj ndeshjeje ishte historike.